

ELVIS BRAMO

**NJË VËSHTRIM GJUHËSOR PËR RIMARIN E POEZIVE
TË PJETËR BUDIT**

Hyrje

Kjo mënyrë paraqitjeje e një fragmenti të shkëputur nga një studim më i plotë për poetikën e P. Budit¹, është përgjithësisht e re në traditën e studimeve tona. Vetëm nga viti 1955 e këndeje, ka të dhëna që janë bërë përpjekje për rimar të ndonjë vepre letrare, siç është një shtojcë në studimin e K. Ashtës “Fjalori i plotë i nxjerrun nga shkrimet e Ndre Mjedës dhe rimari”.² Prej gjuhëtarit Mina Gero, mësojmë se edhe studiuesi durrsak Shefqet Karaja ka punuar për një “Fjalor të rimave të shqipes”.³ Studiuesi i njohur Shaban Sinani pohon që, veç rimarit të Mjedës nga K. Ashta dhe Karajës – mbetur në dorëshkrim – ka pasur në këtë fushë edhe vepra të tjera, si *Fjalori rimor i gjuhës shqipe*, hartuar nga Alfons Dovana.⁴ Po ky studiues, në të njëjtën revistë që shënuam, jep të dhëna edhe për një fjalor dygjuhësh të rimave në gjuhën shqipe i hartuar nga Leka Bezhani,⁵ me titull *Albanian Rhyming Dictionary* mbi 31500 fjalë-rima, mbështetur në Fjalorin drejtshkrimor të shqipes (1976).

¹ P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006. [Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: Rexhep Ismajli, Botohet me rastin e 440-vjetorit të lindjes së autorit, nga ASH dhe Arteve të Kosovës, Libri 31]

² Vepra, në dorëshkrim, e lidhur në fletë blloku, 1955, që ka 655 faqe, është e ndarë në 5 krerë. Kapitulli V, në faqet 581-655 përfshin *rimarin* e poetit. Vepra në dorëshkrim është në Institutin e Studimeve shqiptare të Universitetit të Shkodrës.

³ M. Gero, *Fjalori rimor i Dritëro Agollit* (Morfologjia e rimemave - Konkordanca – Fjalësi), Toena, 2013. Sa i takon termit “rimemë-a”, lexuesi duhet të ketë njohuri se tashmë, prej vitesh, është ligjësuar përdorimi i tij në gjuhësinë e literaturën përëndimore. Mjafton të themi se në veprën e prof. K. Ashtës, lënë në daktiloshkrim, studimi titullohet “Rimari i Mjedës”.

⁴ Sh. Sinani, *Mjedologji-3*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Lezhë, 2016, f. 62 – 84. [Më tej autori shkruan: “*Fjalori rimor i gjuhës shqipe* i Alfons Dovana, në dy vëllime, dorëzuar për shtyp në vitin 1960, u refuzua pa asnjë vërejtje të shprehur me shkrim prej recensuesve, me shpjegimin se ishte vendosur të botoheshin vetëm librat me një numër të kufizuar faqesh...]

⁵ Po ai, *po aty*, f. 73.

Shënojmë se jemi tërhequr nga poetika e P. Budit, krijuar shekuj më parë, sidomos për rimarin e tij për t'u vlerësuar lidhur me kohën që hartoi ky shkrimtar. "Para se të fillojmë diskutimin, le të sqarojmë termat", shkruante Volteri.⁶ Është vendi të pohojmë se rima (nga *gr. rythmos* – lëvizje e njëtrajtshme, *është barazia e plotë e një ose më shumë rrokjeve fundore të një fjale me ato të një fjale tjetër, duke filluar nga zanorja e theksuar: lir-ì, lumtur-ì, yllë – mbyllë* etj.⁷ Studiuesit nuk e paraqesin rimën si element të domosdoshëm të vjershërimit; ajo mungonte në poezitë klasike greke e romake; duket se në Evropë rimimi i vargjeve ka ardhur nga Lindja rreth viteve 1000 dhe u përhap së pari në poezinë latine mesjetare e pastaj në gjuhët moderne.⁸ Pra, kur krijonte Budi, rima ishte konsoliduar prej kohësh në vjershërimin perëndimor, një fakt që na e sjell edhe akademiku Shaban Sinani, i cili, kur shtjellon rimat prej eptimit foljor dhe prejfoljor në grupin *-ue*, tek Mjeda, flet për një traditë relativisht të hershme dhe përmend Pjetër Budin, duke dhënë në shënime sqaruese 3 strofa të rimuara nga përmbledhja *Poezi*, botuar në Prishtinë⁹. "Tek poezitë e P. Budit, shkruan Sh. Sinani, për herë të parë rima, kryesisht ajo e alternuar, shfaqet si baza e eufonisë dhe kushti parësor i isostrofës."¹⁰ Duhet vënë në dukje se Budi, njohur kryesisht për vepra religjioze të shqipëruara, përveç poezisë, ka edhe prozë origjinale: parathëniet dhe pasthëniet e veprave të përkthyer, të cilat mund të bëhen objekt hulumtimi për disa rrafshet studimi gjuhësor, në mënyrë të veçantë për sintaksën e kohës.¹¹

Për poetikën e Budit

Botuesit e Budit dhe studiues shqiptarë të traditës e ditëve tona si dhe albanologu danez, G. Svane, bien dakord se vjershërimi i Pjetër Budit përmban gjithsej 3092 vargje, ndërsa publikimi më i fundit nga akademiku R. Ismajli, numëron 3048 vargje.¹² Me ndonjë përjashtim të vogël, me gjithë asonancat, vjershëria e Budit ka po kaq fjalë rima, sjellë sipas skemës së alternuar ABAB, p.sh.:

Gluhe conë i kërsh^utenë
Të mos e spexonjë mot^uñë
Ndë përrallëzë e ndë rrenë,

Po shpëresënë ta venë
N kishë t' shintë tue votë,
E për fë (t) të kërsh^utenë

⁶ T. Plangarica, *Në tekst për tekstin*, Shtëpia botuese "Sejko", Elbasan, 2002, f. 7.

⁷ F. Leka, *Fjalor i termave të letërsisë*, Infobotues, Tiranë, 2013.

⁸ Po ai, *po aty*, f. 332-333.

⁹ Sh. Sinani, *Mjedologji-3*, Enti botues "Gjergj Fishta", Lezhë, 2016, f. 114-115.

¹⁰ Po ai, *po aty*, f. 75.

¹¹ Është fjala për parathëniet e pasthëniet e veprave: *Doktrina e Krishtenë, Pasqyra e të rrëfyemit dhe Rituali roman*, me: 3-4 faqe., 10 faqe., 69 f. e 26 faqe. (Shih: P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006, f. 31.)

¹² P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006, f. 30.

E sã kafshë për të nkotë,

For (t) ta lusë Tënëzonë.¹³

Të pīm të pākorë
Ruhī mos lakëmoni,
Ndë doni me u ardh mbë dorë
Gjithë qish ju dëshëroni.¹⁴

Baroku budian

Kur shkruajmë për vjershërimin e shkrimtarit Pjetër Budi, kemi rastin ta lidhim produktin e tij letrar në poezi me epokën e barokut dhe lindjes së tij në Evropë, kohë që i referohet shek. XVI, në Spanjë e pastaj me radhë, në Itali, Francë e Gjermani. Përcaktojnë studiuesit tanë se ky drejtim letrar, në letërsinë tonë, zë fill me P. Budin, i cili, sipas njërit prej njohësve më të mirë të këtij autori, Zeqirja Neziri, “mund të konsiderohet si përfaqësues i denjë dhe letrarisht më i plotë i barokut religjioz shqiptar dhe se vjershërimi i Budit, për letërsinë shqiptare paraqet një thesar shumë të çmueshëm kombëtar, me të cilin ajo rreshtohet krahas letërsive të tjera evropiane më të pasura”.¹⁵

Më tej, për barokun budian mund të shtojmë se, brenda këtij drejtimi letrar, poezia e tij përmban përbërës të efekteve të jashtme, për ta mahnitur lexuesin, ka zbulurime plot emfazë, situata të papritura e të ndërlikuara; me plot eufuizma: me stil të fryrë, artificial, me aliteracione, metafora të errëta, antiteza, pyetje retorike, që janë tregues të stilit eufuistik.¹⁶

Në këngën II, për shembull, Budi paraqet dënimin hyjnor për mëkatarët në zë e të panjohur, të pasur dhe lakmitarë, brenda dy strofave, ngarkuar me një leksik në skena aq të rënda danteske për t’u përfytyruar, duke ia sjellë pranë lexuesit e duke e nxitur të gjykojë për veten se mortja i pret:

Qi njoftunë mir’i ke,	<i>Aq qelbëtë e mëndryem,</i>
Se patnë folë me tÿ.	<i>Eshtënat mishit dām</i>
Tashti me gojë plot dhë	<i>E sÿtë keq gërryem,</i>
<i>Dergjenë ndë vorr të zÿ,</i>	<i>Shëmtuoshim për të pām.</i> ¹⁷

Nga ana tjetër, shfaqje të barokut, te Budi, janë edhe skenat tragjike e dramatike të ferrit, mundimet e mëdha që Perëndia u dërgon njerëzve mëkatarë,

¹³ Po ai, *po aty*, f. 281, 283.

¹⁴ Po ai, *po aty*, f. 273.

¹⁵ Citohet sipas veprës *Ligjërimi rreth tekstit letrar poetik* të Anton Nikë Berishës dhe Labinot Berishës, Faik Konica, Prishtinë, 2017, f. 54.

¹⁶ F. Leka, *Fjalor i termave të letërsisë*, Infobotues, Tiranë, 2013. Termat *eufuizma*, *eufistik*, kanë hyrë në letërsi nga heroi i romanit “Eufues” ose *Anatomia e shpirtit* i shkrimtarit anglez Y. Lyly (shek.XVI), krijimet e të cilit u quajtën me stilin eufuizëm. [Shih zërat *barok*, *eufuizëm*, *gongorizëm* dhe *marinizëm*.]

¹⁷ P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 20026, f. 91.

deri edhe dënimin nga lart që u vjen qyteteve biblike të Sodomës dhe Gomorës, deri edhe vajet e Marisë, kur sheh Birin që vdiste në kryq!

Pra ashtu e dërgove Lotnë	<i>S'i ndëjeu as i priti,</i>
E sodomitëve u thë:	As faqenë ua dëftoi,
<i>Mosni ashtu gjithë motnë,</i>	Po mëninë e nxiti
<i>Sodomī e Gomorē !</i>	<i>Këncō jete i faroi.*¹⁸</i>

Rimat dhe përsëritjet

Kreu, nga po marrim materialin për shqyrtim, ka 50 strofa, me 200 vargje, hartuar në 8 rrokësh, me pak shmangie të numrit të rrokjeve; vargjet kanë rimema të rregullta, me gjithë asonancat, siç shihet në modelet e sjella më lart, ku asonancat janë nënvizuar në 2 klauzola (*motnë – nkotë// votë – Tënëzonë*). Dyqind fjalët fundore, përndryshe klauzolat, të marra nga vargjet, mund të ndahen sipas klasave:

Folje	77	rimema	Përemra.....	17	rimema
Emra.....	51	“	Ndajfolje.....	15	“
Mbiemra....	38	“	Parafjalë.....	2	“

Në këtë pikëvështrim, kjo pamje do të përfshinte *morfologjinë e rimemave*, thënë ndryshe, variantet leksikogramatikore të klauzolave të përdorura në mbyllje të vargjeve që përbëjnë strofat. Më tej kalohet në të gjithë tekstin poetik. Me një shikim të shpejtë mund të vërehen përbërësit leksikogramatikorë të fjalëve-rima, ku mbizotërojnë foljet, emrat dhe mbiemrat, përballë përemrave, ndajfoljeve dhe parafjalëve, të cilat, si rima, dalin tepër rrallë, pasi kuptimi leksikor i tyre nuk është i plotë dhe i mëvetësishëm, ai ai i fjalëve leksikore-emërtuese.¹⁹

Siç dhe dihet, rimat e dendura foljore, në raporte të rritura me klasa të tjera fjalësh, ulin nivelin e poezisë dhe vargjet bëhen monotone. Nga ana tjetër, përsëritja e tyre në segmente të afërta, ka si rrjedhojë zbehjen e asaj që quhet *poetizim i fjalës*; një përkatësi e domosdoshme kjo e vjershërimit. Dukuria tjetër në rendin e klauzolave të poetikës së Budit, janë rimarrjet e dendura në të cilat takojmë rimat, përsëritje që shfaqen jo vetëm në largësi paradigmatiche, por jo rrallë edhe brenda strofës ose strofave të njëpasnjëshme, sikundërse mund të shihet qysh në Kreun e parë që emërton vetë Budi: “Këtu desha me vëm këtë imnë qi pakmos shembënjenetë me atë sekuencjet qi thuhet për të vdekunit, ndōnëse asht pak nçtuom e mēnguom, si për të pājtuomit të fjalëvet,

* faroi – i shfarosi, i zhduku kësaj jete.

¹⁸ Po ai, *po aty*, f. 163-165.

¹⁹ M. Çeliku, *Parafjalët e shqipes standarde*, Shtëpia Botuese & Shtypshkronja "Ilar", Tiranë, 2019, f. 16.

ashtu ende për ndonjë frujt të mirë të shpirtit”²⁰

... me mëni	... ban dëshmi	... cokëllimë	... vinjë
... ndë vonë	... po thonë	... anë	... vonë
... të zī	... e mëni	... shkepëtimë	... çkyretinjë
... përvëltonjë,	... tonë. (f.63)	... gjamë,	... tonë.
...si trumbetë	...të këlthesë	...t'i gërshesë	...mkate
...të këmbonjë	...t' debërtonjë	...frikë	...për hie
...të shkretë	...t' u thërresë	... ndëjesë	...ta pe
...ta kërkonjë	...t'i nqonjë,*	...ditë	...arrësye
...jemi rām	...të dalë	...me qenë	...të rrijë
...me ligjëruom	...ashtë shkruom	...me shpëtuom	...pezmatuom
...me pām	...gjithë fjalë	...anë e pranë	...t'i dijë
...me ndimuom	... ligjëruom	...me rrëzuom	...kemi vepruom; (65)
...t'i shoho	...me s̄y	...ndë fityrë	...me shpëresë
...t'i shpëtonjë	...me u afruom	...me mëni	...penduom
...t'i njoho	...mbī	...dyllë	... ndëjesë
...t'i meritonjë.	...shpëtuom	...përpara tī	... i ngushëlluom. (67)
...i vdier	... tonë	...i vonë	...dridhenë maltë
...e frikë	...mbë jetë	...i drejtë	...me u dëftuom
...mëshërier	...ndë e vonë	... tonë	...si mjaltë
...mb'atë ditë.	...vetë	...të keqtë	... farmakuom.
...si shpatë	...t̄y	...me s̄y	...me s̄y
...me gjukuom	... i ngushëlluom	... ngushëlluom	... ngushëlluom
...si flakë	... zī	...ndë të zī	...ndë të zī
...me shëmtuom	...palavuom*	...n'të larguom. (69)	...n'të larguom. (69)
...menguom	...s'jam i tanë	...i mirë	...pate ndëjyem
...t̄y fëjyem	...me rām	...aqë lëvduom	...të përmkatënuom
... farmakuom	...për të lanë	...të dëlirë	...patmë fëjyem
...tue rrëfyem.	...me pām.	... i ngushëlluom.	...n te larguom.

²⁰ Po ai, po aty, f. 63-69; 71-77.

* t'i nqonjë - t'i zgjojë nga gjumi

* *palavuom* mb.- nga “palavī”, fjalë palavī, fjalë marroke, e pa vend, fjalë e papranueshme (Zadrimë).

...tue kujtuom	...me t' u afuom	...tonë	...më venë
...ndër në	...i pāfë,	...për zanë	...cë bardhë
...të numëruom	...me shukuom	...dërgomë	...posi
...për dhë;	...përmbi në	...të tanë . (71)	...me më marrë.
...shoqëni t'errë	...e helmuom	...me më ndimuom	...të çkushëlluom
... tanë	...përdhë	... tue ma dhanë	...ditë
...ndë ferrë	...verbuom	... i ngushëlluom	...cë mërekulluom
... me më zanë ;	...prej të.	...përzanë	...pikë
...vepruom	...me thanë,	... të jenë zanë	...me mëni
...këtë jetë	... me shpëtuom	...rrethuom	...me t'errëzuom
...reneguom	...cë tanë ,	... dhanë	...errë e zi
...të drejtë	...n cë lëvduom . (73)	...me u dënuom	...lëshuom;
...me furī	...kërrabullorë	...gjithë gatī	...një fjalë mbi
...perequom*	...si limë	...e errë	...cë lëvduom ,
...të zi	...n dorë	... mëni	...goje cë tī
... të farmakuom ;	...shkrepëtimë	...vdjerrë,	...t' u jetë urdhënuom
...një mëni	... mëni	...dobī	...të mirë
...me rrëzuom	...t' idhënuom	...me shkuom	...të lulëzuom
...të ferrit zi	...t'errë të zi ,	...me hy	...pasëqyrë
...t' amshuom;(75)	...me u munduom;	... me shpëtuom ,	...qëruom
...ndë shintet fë	... të ngushëlluom ,	...me zotënuom	
...me qenë pëlqyem	...ke rrij,	...regjënī	
...me rrezë	... të lëvduom	... me lëvduom	
...me u shkëlqyem.	... të tij ,	... të tī . (77)	

Me këto vija korrelative (bashkëlidhjeje) jo vetëm vihet në dukje larmia e klauzolave (rimemave) në planin morfologjik, por dalin në pah edhe përsëritjet e këtyre fjalëve-rima, për të bërë të mundur edhe grupimet e tyre sipas klasave. Njëherësh, gjatë vështrimit të tyre, shihet qartë edhe ana numerike e këtyre rimarrjeve të rimemave, si dhe dallimi i raporteve të një kategorie

* *parequom* – përfytyruar. Ky shpjegim i studiuesit R. Ismajli mund të jetë dhënë edhe për kontekst, sepse përfytyrimi aludon për *djemnit – djajt – dreqërit*. Pra, kuptimi këtu ndoshta largohet nga semantika e zakonshme e kësaj fjale të Budit “përgatis, bëj gati”, nga italishtja *apparecchiare*.

leksikogramatikore ndaj të tjerave që ka përdorur autori ynë në shekullin kur krijoi në vargje. Edhe afria e largësia e këtyre lidhjeve hetohet nga vargu në varg e nga strofa në strofë, brenda fjalisë, frazës apo thënies e tekstit.

Këtë lidhje në rimemat e klauzolave, që shihet më sipër, studiuesi M. Gero²¹ e ka quajtur *shndërresë* (transformë) e *lidhjeve rimore letrare të poezisë*. Autori jep edhe konceptin e *lidhjeve rimore gjuhësore*. “Me këtë rast, shkruan ky gjuhëtar, e ndjejmë të nevojshme të bëjmë dallimin ndërmjet lidhjeve rimore gjuhësore dhe atyre letrare. Duke bërë njëfarë përqaasjeje të sintagmave me lidhje të lirë sintaksore ndërmjet përbërësve në një strofë dyshe, vëmë re se veçoria e *lidhjes rimore letrare* qëndron në atë që në to përbërësit rimorë lidhen midis tyre mbi bazën e sintaksës poetike: duhet të kemi rimemën e parë si “gjymtyrë drejtuese” në vargun paraardhës dhe, mandej, mbi bazën e ngjashmërisë së plotë a të pjesshme të tingujve-fonema pas theksit, të kemi rimemën tjetër si “gjymtyrë të varur” në vargun pasardhës....Vargu i gjymtyrëve në *lidhjet rimore letrare* është i kufizuar, në varësi edhe të llojit të strofës ku përdoren. Ndërsa në *lidhjet rimore gjuhësore*, sasia e përbërësve të vargut është e pakufizuar..., duke u zgjatuar vargu pambarim.” Për shembull, tek Budi, në strofën katërshe:

Se për ju *jam dërguom*
Mbë këtë jetë *me lëm*,
Për ju *me u munduom*
Gjithëve *me u çpërblëm*.

rimemat foljore letrare lidhen mbi bazën e ngjashmërisë fonetike që shfaqin fjalët fundore të vargjeve, pas theksit gjuhësor të tyre, të cilat dalin në harmoni fonetike të njëjtë apo edhe të ngjashme si: ...*jam dërguom/ me u munduom/ me lëm / me i çpërblëm*; kurse për lidhjet rimore gjuhësore, gjykohet ndryshe: përbërësit këtu janë në lidhje të lirë e të pakufizuar. Sipas këtij interpretimi, në strofën katërshe të mësipërme, gjymtyrët kryesore shprehen në dy fjalët klauzola të dy vargjeve të para, kurse ato të varura, ndodhen në vargjet 3 dhe 4.


Nga pikëshikimi i sintaksës

Në vështrimin sintaksor, sa u takon fjalive dhe frazave, nuk duhet menduar se në poetikën e Pjetër Budit do të gjejmë ndërtime “*varg e fjali*” apo “*strofë e frazë*”, si dalin në më të shumtën e rasteve gjatë vjershërimit të metruar. Për shembull, strofa e mëposhtme, është e organizuar sintaksorisht me

²¹ M. Gero, *Fjalori rimor i Dritëro Agollit* (Morfologjia e rimemave-Konkordanca-Fjalësi), Botimet Toena, Tiranë, 2013, f. 31.


treguesin “varg e fjali”, siç na vijnë edhe shumë poezi të traditës sonë letrare poetike:

Tue pāmë /se s’jam i tanë/
Ndë hīrt tand kund me rāmë,/ /
As mbë qiellt për të lanë/
Shintënë dritë me pāmë./²²




Kurse strofa në vijim, ka tjetër organizim sintaksor; fjalitë ndërtohen në hapësirën e dy vargjeve dhe strofa është një frazë me ndërtim simetrik, ku njësitë predikative me paskajoren gege duhet të plotësohen semantikisht nga vargjet 3 dhe 4; çka e shfaq edhe skema:²³

“S’kam sÿ /me t’u afruom
Porsi nja i pāfē,/ /
As i denjë/ me shukuom/
Qielitë përmbi nē.”²⁴




Edhe më qartë del ndërtimi i quajtur këtu “varg e fjali”, dhënë në vijë lineare.

“Disave përngjat u shkoi,
S’i trazoi mb’atë ditë,
Disa idhun i plagoi,
Mbramanënë nuk e pritnë.”²⁵



Ndërsa strofa në vijim organizohet sintaksorisht si frazë më vete, ndonëse lidhëza “E” tregon se periudha është vazhdim ngjitur i një tjetre:

“E Kainë s’e përzū,
Faqenë ia lulëzoi,
Se gëzueshim ia prū,
Ndë një ças e bēkoi.”




²² P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006, f. 71.

²³ Për këtë paraqitje skematike, shënojmë: Fr = frazë; këndi i gjerë më pas tregon vendin që zë fraza në hapësirë; Fjdr.= fj.drejtuese; fjr. = fjali kryesore; shkurtime të tjera të fjalive jepen me simbolet e funksioneve, b.f. Fjvq = fjali e varur qëllimore, ose: Fjvsh. = fjali e varur shkakore etj. Në rreshtin e parë vihen QOS= qendrat e organizimit sintaksor, d.m.th., fjalitë kryesore dhe ato drejtuese, kurse në rreshtat e tjerë, hierarkia e varësisë së përbërësve predikativë, sipas funksionit.

²⁴ P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006, f. 71.

²⁵ Po ai, *po aty*, f. 89. (Mbramanënë - mbrëmjen.)

Një ndërtim interesant në planin e sintaksës, te Budi, shihen rastet e fjalive pyetëse retorike radhazi nga strofa në strofë, të cilat ndiqen përgjithësisht prej vargjeshe jofjali, siç janë ato të f. 87, ku përfshihen edhe përgjigjet në krye të 4 strofave; duke u përfutur kështu një tekst i pandashëm, madje edhe i krijuar në trajtë simetrie e në përgjigjet e autorit që nisin në strofën VII, e ndjekin në 5 të tjera, siç mund ta sjellim me një skemë të thjeshtë, ku secila përgjigje i referohet secilës pyetje:



Në këtë “rrjetë korrelate” janë gjithsej 7 fjali pyetëse retorike (nga e djathta), të cilave u vihen po 7 përgjigje – vënë nga e majta e figurës, sepse strofat e originalit dalin në monokolonë. Është një tekst i ngjeshur me “pyetje-përgjigje” – me ndërtime dyshe si në replikat e një dialogu, por është vetëm poeti që ligjëron. “Pyetja, shkruan R. Përnaska, bëhet për të gjetur remën, e cila del në dritë të përgjigja. Në thëniet që kanë në ndërtimin e tyre fjalë pyetëse, rema shprehet pikërisht nga këto fjalë pyetëse. Thëniet që i përgjigjen pyetjes së plotë kanë remë të përbërë, të formuar nga kallëzuesi dhe një gjymtyrë tjetër

(p.sh., tema shprehet nga kryefjala, kurse rema nga kallëzuesi dhe kundrinori). Thëniet që i përgjigjen pyetjes së pjesshme kanë rema të thjeshta.”²⁶

Tek sythi për frazën, është me vend të kemi parasysh se në studimet e sotme sintaksore bëhet fjalë për njësi mbifrazore (superfrastike), të cilat vijnë e bëhen objekt i sintaksës, siç janë: *thënia*, *paragrafi* dhe *teksti gjuhësor*. Edhe në Gramatikën normative të shqipës është çekur kjo çështje: “tani po bëhet fjalë edhe për njësi më të mëdha sintaksore se periudha. Është pak a shumë e njohur qenia e njësisë semantiko-strukturore të përbërë prej fjalish të mëvetësishme a periudhash të ndryshme, e cila ka një përmbajtje të lidhur, të organizuar zakonisht me mjete gramatikore. Mund të quhej thënie e lidhur”²⁷ Por nuk është trajtuar apo zhvilluar ky koncept dhe janë të paktë studiuesit që kanë bërë objekt të punës së tyre vështrimin sintaksor të njësisve më sipër, qoftë edhe me përshkrimin e tyre strukturor. Ndoshta, është i vetëm gjuhëtari Tomorr Plangarica që sjell risi për termin *tekst* dhe lidhjet që ka me *thënie*. Në veprën e tij “Në tekst për tekstin”, ai shkruan: “Duhet theksuar se termi *tekst*, ashtu si *discours* dhe *thënie* merr vlera të ndryshme, por ai përdoret shpesh si një ekuivalent i thënies, si një vazhdimësi gjuhësore autonome, gojore ose e shkruar, e prodhuar nga një ose më shumë thënës, në një proces thëniezimi, në një situatë të caktuar komunikimi.”²⁸

Te Budi, f.v., kreu II “Këtu duo të thom pak fjalë n cë përmenduni cë mortsë e madhëstiet e n cë pānjoftuni cë nierëzet”²⁹, gjejmë thënie poetike të lidhura në mënyrë të pandashme dhe simetrike, në raportin 3 strofa me 3 strofa, të cilat bashkohen sintaksorisht me konektivin kundërshtor *ma* (it.) – dhe, si mund të shihet edhe tek ky fragment, në ekuilibër sasior.³⁰

²⁶ R. Përnaska, *Gjuhësi...gjuhësore- I*, Shtëpia Botuese “Maluka”, Tiranë, f. 184. (Pa vit botimi).

²⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe II*, ASHSH, IGJL Tiranë, 1996, f. 64.

²⁸ T. Plangarica, *Në tekst për tekstin – Studime*, Shtëpia Botuese “Sejko”, Elbasan, 2002, f. 14.

²⁹ P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006, f. 79.

³⁰ P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006, f. 105 – 107.

“Ai Adami i lëvduom,
Me Evënë dy të rī,
Mbasi qenë krijuom,
Pak mbetnë në nierëzī.

Përse s’ deshnë me ndëgjuom
Urdhëninë qi qe dhanë
E Sinëzot urdhënuom
Njaj peme me mos ngranë:

“**Se** mb’atë horë qi ta zini
N dorë n coje me ngjënuom,
Me vdekunë mortjet kini,
Kënci shekulli me shkuom.”

Ma ata tue qenë
Dy të bukur e të rī,
Si Sinëzot ishnë dhanë
Pa mkat, pā majshtrī,

Nd’atë paq të ngushlluom
Trī horë e gjymzë mbī,
Ndë e vonë, si a shkruom,
Erdh djalli me majshtrī,

Me ta tue ligjëruom,
Si një gjarpënë i zī,
Ndjer i bani me ngjënuom
E i shtiu ndë mēnī.

Strofa II, si përmbajtje, del në marrëdhënie shkaku me atë të strofës I, sikur shkëputet nga kufiri sintaksor që ka caktuar poeti, duke vënë pikë në fund të 4 vargjeve ta para. Vjen e shfaqet ajo dukuri që M. Domi e quante *segment a parcelizim*, që do ta shpjegojmë më vete në këtë shkrim; po kështu fjalia e parë e strofës III që del e ndërmjetuar (Lexo: *Se mb’atë horë... Me vdekunë mortjet kini*), del e shkëputur nga trupi i frazës, derisa takojmë konektorin *ma*, i cili u prin 3 strofave që qëndrojnë në marrëdhënie kundërshtie me paraqitjen e 3 strofave të para.


Trajtimi bashkëkohor

Problemi i shtruar këtu, nuk mbetet jashtë diskutimit edhe në gjuhësinë e sotme. Në disa tekste të filologjisë franceze, për shembull, në librin “Komunikimi”, nënvizohet se ne komunikojmë me mesazh. Ky term, theksohet se shënon një sinjal ose tërësi sinjalesh, që transmetohen gjatë një akti komunikimi. Ka edhe fjalë të tjera, me shtrirje më të gjerë, por po aq të rëndësishme, që emërtojnë mesazhet. E tillë është *thënia*: një thënie është një mesazh gjuhësor, përgjithësisht në trajtë gojore, sepse mesazhi në trajtë të shkruar zakonisht quhet *tekst*.³¹ Autorët e cituar shkruajnë se në këto raste flitet për *analizën e ligjëratës*, *analizën e tekstit* etj., por këto disiplina trajtojnë më shumë koherencën semantike të thënieve, sesa strukturimin e tyre gramatikor. Sintaksa tradicionale, e cila është *ndërfjalimore*, duhet të plotësohet me një *sintaksë tejfjalimore*.³²

³¹ Baylon, Christian & Mignot Xavier, *Komunikimi*, Logos-A, Nathan Université, 2003, f. 21.(Përktheu: prof. Xhevat Lloshi).

³² Po ata, *po aty*, f. 37.

Një veçori e dukshme në vjershërinë budiane vjen e përforcohet përgjatë ndërtimit të tekstit, që, në rrafshin e sintaksës poetike, shfaqet në ato raste kur strofat plotësojnë njëra-tjetrën, edhe si vartësi semantike, por edhe në planin formal gramatikor. Në një tekst të tillë prej 9 strofësh (f.93-95) në të cilin strofa e parë lidhet me ato më përpara, nëpërmjet konektivit “pra”,³³ që në Gramatikën shkencore jepet si lidhëz bashkërenditëse përmbyllëse,³⁴ në mungesë të tij, nuk mund të arrihet kuptimi i plotë, nëse e lexojmë pa disa pjesë para saj. Kjo vjen për shkak se ajo bën konkluzionin që përmban fjalë, fraza apo thënia më përpara, ku ka një tekst prej 13 strofash. Nuk e themi këtë për shkak të pikësisht jo korrekt të autorit dhe sipas rregullave sintaksore, por duke u bazuar në kuptimin që mbajnë të dyja pjesët poetike të lidhura me konektivin “pra”. Ja si lidhet teksti poetik nga f.89–95 përpara dhe pas konektivit “pra”, shprehur me folje në vetën II/njëjës dhe vetën III/shumës:³⁵



Pas konektivit “pra”, vjen rrethorori “ashtu” që shpreh gjithë përmbajtjen funksionale të njëjësive predikative sipas strofave më përpara, kurse 8 vargjet në vijim (djathtas) përshkruajnë çfarë ngjet në njësitë e zgjedhura. Në këtë

³³ L. Mëniku, *Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe*, Albas, Tiranë, 2014, f. 38.

³⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 1995, f. 406. [Vërejmë se lidhëza *pra* në këtë tekst akademik nuk del në radhët e 4 lidhëzave: *andaj, ndaj, pa, prandaj*, por e gjejmë tek shembulli i fundit ilustrues që japin autorët: *Mendimi ynë ishte më i argumentuar, pra dhe më i drejti.*]

³⁵ U morën vetëm disa vargje me predikativitet (njësi-fjalë) të strofave nga f. 89 – 95.

* Kafshëvet mbē këtë dhē – gjërat e kësaj bote, sipas besimit fetar: të kësaj jete.

* Ū, ēt = uri dhe etje duke duruar.

mënyrë, teksti prej 9 strofash (pas konektivit) nuk mund të qëndrojë pa 13 strofat majtas. Këtë dukuri të lidhjes mes miniteksteve me anë të këtij konektivi (pra), e ndeshim edhe në këngën II, në masa më të vogla ligjërimore, por me të njëjtën strukturë, veçse në vetën II/njëjës në të dyja pjesët, ku ndjehet prania e autorit:

“O, i pāfat, kushdo jē,	Pra ashtu mos e pērcill
Me mkat gjithē palavuom,	Sot mbē nesēr tue thanē
Aqē m perikullē jē	S’ende s’kemi zanē fill
Me qenē vdjerrē e dēnuom,	Me shkuom jetēnē tanē,
Sā s’mund me kallēzuom	Pērsē mortja s’tē shukoi
I mjeri mbē këtë jetē	As pēr plak as pēr tē rī,
Ditē e natē tue shkruom,	Por jetēnē ta shkurtoi
As me thanē tē vērtetē.	Kur s’e priti nierī..... ³⁶

Segmentimi a parcelizimi sintaksor

Kjo paraqitje e shkurtër, në një artikull reviste, bëhet në pajtim me atë që në kohën e sotme studimet gjuhësore vijnë e shtrihen nga njësia “frazë” tek njësia “tekst”. Lidhur me këtë pohohet se raporti mes frazës e fjalisë është i shpjegueshëm si vijon: ashtu si shumë fjalë formojnë një fjali, po kështu, shumë fraza formojnë një tekst. “Fjala, fraza dhe teksti dallojnë, për së paku, në dy aspekte: jepen të gjitha në normë gramatikore (morfologjike dhe sintaksore) dhe transmetojnë informacione (mund të thuhet edhe që janë semantikisht plot, në ndryshim nga pjesët e tjera të ligjëratis, si b.f., lidhëzat, parafjalët dhe nyjat që funksionojnë vetëm në lidhje me emra, mbiemra e folje e janë pra semantikisht boshe.)³⁷ Diferenca më e madhe mes tyre, duket ama se qëndron në gjerësi: fjala vjen si unitet informues minimal, kurse teksti si unitet informativ maksimal.³⁸ Për të parë nëse realizohet treguesi “informim”, segmente të ndryshme poetike nga Budi duhet të vështrohen nga ana sintaksore, si u veprua më lart.

Pranë kësaj të dhëne gjuhësore, për vjershërimin e Pjetër Budit do vënë në dukje edhe shfaqja e *segmentimit a parcelizimit* të periudhave (frazave) në strukturën e strofave, kur poezia organizohet si e tillë, përndryshe, në monokolonë. Sipas gjuhëtarit M. Domi “parcelizimi është një nga mjetet kryesore të stilit të thyer. Kjo mënyrë e organizimit të thënies mund të gjendet

³⁶ P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006, f. 101.


³⁷ S. Telve, *L’italiano: Frasi e testo*, Carocci editore, Bussola, S.p.A. Roma, 2013, p. 23.

³⁸ Po ai, *po aty*, f. 24.

në ndonjë rast edhe në gjuhën e folur, me vlerën e diçkaje të shtuar, të shkëputur nga ajo që është thënë përpara, por, në ditët tona, ajo është bërë në gjuhën letrare një mjet sintaksor e stilistik gjithnjë e më i përdorur.”³⁹ Këtë copëzim, kur nga indi i frazës vjen e shkëputet një fjali apo një strukturë e një fraze, e dallojmë jo rrallë edhe në vjershërinë e P. Budit; ato nderen përgjatë gjithë poezisë së tij, më së shumti, njësi kallëzuesore shkak apo përcaktore, si për shembull, në vëllavrasjen e parë të njerëzimit, kur Kaini mizor vrau Abelin e pafajshëm:


“Qish bane, i pāfati,
O qofsh gjithë mallëkuom!.....

Se giaku i tyt vëlla
Qi derdhe përmbi dhēt
Erdh përpara muo rā
E mbē t̄y po thërret;....(f.129)



“Pive gjaknē tyt vëlla
E vrave me dorē tande!.....

I cilli and̄y u dā,
Vo muor një shkretētī,
Ditē e natē tue qām,
Tue pām mortnē m s̄y;....(f.129)






Më qartë dukurinë e sementimit apo parcelizimit të frazës a thënies, mund ta paraqesim nëpërmjet strukturës së një thënieje në prozën moderne, sjellë nga shkrimtari I. Kadare:

“Ishte e tepërt të thuhej
se një gjë e tillë,
përpara se të ishte e palogjikshme,

E palogjikshme për Pastërnakun, që t’i
shpikte vetes diçka që nuk e nderonte.
E frikshme për Stalinin, që të lejonte
përhapjen e trillimit, i cili mund të
vihej në dyshim.

do të ishte e frikshme.

Sepse jehona e ngjarjes, jo vetëm nuk u pengua prej tij, por është nxitur.⁴⁰

Të gjitha frazat e shënuara me shigjeta janë shkëputur nga indi i periudhës majtas, por nuk mund të qëndrojnë kuptimisht jashtë strukturës së saj. Kjo pamje është tashmë në përbërës stili në shkrimtarinë e autorit që prej më se dhjetë vitesh.

³⁹ M. Domi, “Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore”, *Studime filologjike*, 1984/4, f. 61.

⁴⁰ I. Kadare, *Kur sunduesit grinden*, Onufri, Tiranë, 2018, f. 68.

Për t'u kthyer përsëri tek poetika e Budit, ndodh shpesh që njësia e segmentuar të vendoset përpara një numri strofash, siç ngjet tek thirrja e *Noe Profetës*, të cilën autori e sjell në thonjëza si ligjëratë të drejtë ku pjesëza mohuese “mos” përdoret si folje, duke u bërë e tillë me një mbaresë foljore të vetës II/shumës: “mos - mos+ni”: “*Se mosni, o të këqī./Mosni ashtu të helmuom./Mosni se jeni gatī./Me qenë vdjerrë e dënuom...* (f. 133). Jo rrallë, njësia e parcelizuar, vihet në krye të frazës-tekst, si u shpjegua më sipër marrëdhënia mes tekstit e frazës, nga ana strukturore; në këto raste fjalia e shkëputur ka lidhje kuptimore të dyfishtë: me strofën e parathënë dhe me atë pasuese, si në shembullin e gjetur:

”Disa t’urtë e të ndëgjuom.
Ishnë bām turp e çminjë.

Se Sinëzot ishnë dām
Gjithë ligjeshi cë tij,

Fjalia e nxjerrë
majtas
është në mes
të 4 vargjeve.

Veçë Abraamit qi bām
Shinitinë emënë të tij... (f.161)

Shembuj si këta nga poezia e Budit, janë të vlefshme edhe për një vështrim historik të sintaksës së shqipes, edhe pa qenë të veçanta për shfaqje në vargjet e poetikës së tij.

Dukuria e kapërcimit sintaksor në poezi

Në krijimtarinë poetike, krijuesit njohin dukurinë stilistike e sintaksore të *l'enjambement*, ose kapërcimit, siç mund të përkthehet si term në gjuhën shqipe.⁴¹ Fjalorët terminologjikë, si ai autorit italian Gian Luigi Beccaria “*Dizionario di linguistica*”,⁴² e përfshijnë si skaj gjuhësor, me shpjegimin: *Alternim hipotetik i përkimit a harmonisë mes unitetit të vargut dhe unitetit sintaksor; përndryshe një thyerje pak a shumë e fortë në fund të vargut të sintaksës ose të një sintagme (deri edhe të një fjale). Ky përkim i kërkuar i harmonisë së unitetit sintaksor brenda një vargu, është karakteristikë e poezisë së kultivuar, kërkon mjeshtëri dhe aftësi gjuhësore, përgatitje shkencore filologjike dhe rrallë shihet në poezinë popullore. Te Mjeda ka shfaqje të*

⁴¹ Për këtë term sintaksor e stilistik, shih edhe Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatike*, Albas, Tiranë, 2012.

⁴² Gian Luigi Beccaria, *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Nuova edizione, Piccola Biblioteca Einaudi, Torino, 2004. [Termi vjen nga frëngjishtja, për një paradoks historik: Boileau, në shek.XVI, e ka përdorur këtë dukuri për ta sjellë si “shkelje”gjuhësore në poezi...]

dendura të kapërcimit (*enjambement-it*), sidomos në poemat e tij klasike, thurur në tingëllima, si dhe te “Andrra e jetës.” Për shembull:

“E kqyr: ndër male po përhapet <u>shkëndija</u>	...Vijnë bylbylat ku <u>prendvera</u>
<u>e lirimët t’Atdheut</u> ; mshehtas <u>shëtiti</u>	<u>N’pyjë t’veshuna</u> po i thrret... ⁴³
<u>kësollë për kësollë</u> rreth buneve e soditi,	E din idhun regj Davidi,
frymë të re tuj shprazun për gjithkahna <u>hija</u>	E din lott që paprâ qet,
<u>e Skanderbeut</u> . Qe ndër djepa <u>rrisin</u>	Kur shef morden se <u>kositi</u>
<u>nanat e Hotit</u> djelmëninë ushtore,...” ⁴⁴	<u>Anembanë</u> krajlninë e vet.... ⁴⁵

Ndodh që kjo dukuri të shfaqet edhe brenda një njësie predikative, ndarë në dy vargje, si në shembujt në vijim:

Me gjak e me djersë mbi
Ketë jetë keq e shkuosh...



Te poetika e Budit, shfaqja e kësaj dukurie ndeshet rrallë, ngaqë tetërrokëshi nuk krijon aq mundësi thyerjeje sintaksore nga vargu në varg, por edhe pse vjershërimi i këtij autori nuk mëton përbërës të tillë që vijnë e dalin në nivele të larta artistike. Megjithatë, me një vështrim të kujdesshëm, arrijmë të veçojmë disa raste si këto në vijim, ku folje bivalente (e trivalente) vijnë e plotësohen me argumente në vargjet pasuese të strofave. Është përcaktuar tashmë se në shumicën e rasteve, folje të tilla janë ato që grupohen në klasa, si: *verba dicendi et declarandi* (thërras, bëzaj), *verba communicandi* (njoftoj, lajmëroj), *verba putandi* (mendoj, mendohem, kujtoj, kujtohem), ashtu edhe ndërtimet *tautoprosopike*, të cilat dalin edhe me konstrukte me paskajoren geqe (*don me provue, kërkon me folë, pranon me shkue* etj.).⁴⁶

⁴³ N. Mjeda, *Vepra letrare-1*, Shtëpia botuese “N. Frashëri”, Tiranë, 1988, f. 87.

⁴⁴ N. Mjeda, *Vepra letrare-2*, Shtëpia botuese “N. Frashëri”, Tiranë, 1988, f. 46.

⁴⁵ N. Mjeda, *Vepra letrare-1*, Shtëpia botuese “N. Frashëri”, Tiranë, 1988, f. 89.

⁴⁶ T. Kelmendi, *Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2010, f. 91-116.

Aqë sã mã s'kje

Posi vetë kini pâm

Zemërë me i shkuom

Shoqi shoqnë tu'vorruom. (f.100)

Qelbësinet qi të bie

Veçë ndë kie ngjënuom

Përngjat tyne tue shkuom...(f.101)

Pemet, qi paçë thanë...(f.111)

Në shfaqjen e kësaj dukurie, *enjambement*-it, ndodh jo vetëm plotësimi i një fjale, sintagme e grupi më të gjërë, por edhe njësi kallëzuesore, madje, edhe prej atyre që dalin homogjene, njëra pas tjetrës, si:

E Adâmi fort gjëmoi,

Ndë zemër tue thanë:

“Eva muo ma lëvdoi

E më nxiti me e ngranë.”



(f.111)

“O, i madhi Zot fatmiri,

Ti qi jë i vërtetë,

Prej qiellshit këqyri

Të tûtë qi do vetë.” (f.245)



Rendi sintaksor i përbërësve funksionalë

Është një tregues që varet nga disa kërkesa të rregullave poetike klasike, siç është koha kur shkroi Budi dhe bashkëkohësit e tij; është një tregues që mund të vështrohet në strukturën e vargjeve fjali, por edhe në ndërtimin e strofave fraza. Kur shkruhen poezi të rimuara, me metër të njëjtë, b.f., në 8-rrokësh, siç harton P. Budi, krijuesit kërkojnë ta ruajnë masën e rrokjeve, të ruajnë theksat ritmikë dhe logjikë dhe, në anën tjetër, të realizojnë rimën apo asonancën. Krahas këtyre, autorët synojnë të ruajnë qëllimin e thënies, çka lidhet me theksat logjikë. Për shembull, në 4 vargjet në vijim, faqe 195, shfaqet ky rend gjymtyror nga vargu në varg:

Tue thanë: “Mjera unë,..... P + O

Biri im, ti kuj më lë,..... Th + S + O1 + P

M se u bā këjo punë, C + P + S

Qish të keqe patnë n tē ? A + O + P + C

Drita n’qiellshit u shuo..... S + C + P

Ditënë u bā t’errë,..... C + P + C

Gjithë dheu u trishtuo,..... A + S + P

Shigulloi mjet ndë ferrë.⁴⁷ P + C

Çështja e rendit sintaksor për gjuhën tonë, ndryshe, për sintaksën fjalisë, ku gjenerohen natyrshëm fjalitë njëshe të disa llojeve, me mospraninë e

⁴⁷ P. Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006, f. 2006.

subjekteve dhe elipsën e foljeve-kallëzues, ka sjellë atë që rendi i gjymtyrëve dhe i vendosjes së njësive predikative, është i lirë, situativ dhe sipas qëllimit të thënies. Shihet më lart se vetëm nga një herë ndër 8 vargje, dalin në krye të vargut S një herë dhe dy herë P; po kështu ka një variacion në topikën e gjymtyrëve funksionale: kundrinorë, rrethorë e përcaktorë.

Së pari, një hulumtim më vete mund të krijohet me ndjekjen e rendit sintaksor të përbërësve të fjalisë, kryesisht përbërësve funksionalë, siç janë kryegjymtyrët dhe gjymtyrët e njësive predikative. Në jo pak raste, ngjet që në shumë vargje autori i ndërton rimemat me folje: forma të shtjella dhe të pashtjella, qoftë edhe me pjesore mbiemërore, si në pasazhin prej 24 vargjesh (6 strofë), f. 207, ku pozicioni i kallëzuesit del fundor në 15 klauzola, kurse në 9 vargje gjenden mbiemra dhe pjesore mbiemërore, duke zbritur vlerën poetike dhe atë artistike të krijimit në vargje.

Së dyti, është interesante të vihet në dukje se në poetikën e P. Budit, gjejnë përdorim të dendur fjalitë njëshe foljore me vetë të përcaktuar, të cilat vendosen me rregull pas njësive dyshe, më fort, përemërore; f.v.: në strofën e parë të tekstit poetik që po vështrojmë, kryefjala e fjalisë dyshe “*E na kemi dëshëruom*” është përemërore dhe në 3 vargjet në vijim njësitë janë të gjitha njëshe vetore foljore, për të dy strofat e marra në shqyrtim:

E na kemi dëshëruom
Këtë ditë me pām,
Ndonëse qemë shkuom,
Këncō jete qemë rām



Përse na atje ke qenē
Ndē një t’errē e burg të zī,
Sā mot e jetē pritmē
Kund një ndimēzē vetī.



Nën dy strofat në vijim, në secilën anë, vëmë në dukje që fjalitë dalin pa subjekte, edhe për faktin që kryefjala në gjuhën shqipe nuk vjen e domosdoshme për t’u shprehur, si në mjaft gjuhë të tjera, por edhe për praninë e njësive predikative njëshe foljore, siç u shprehëm më sipër. Kështu, në strofën VII, f. 209, autori e ndjen nevojën ta sjellë përsëri subjektin përemëror “na”, në një katërvargësh që ndiqet përsëri nga dy të tjera pa subjekte ndër fjalitë e gjendura nëpër vargje:

Ma tashti na me fē,
Nd’atē burg ka qemē zanē,
Erdh një ngushëllim ndër në
Prej Sinëzot i dhanē...

Jo rrallë, prania e subjekteve, në vargje të ndryshme, vihet re edhe për plotësim të metrikës, numrit të rrokjeve, kur vjershërimi del i matur.

Lidhje me hipotaksë ndërmjet strofave

Nëse i shohim strofat edhe njësitë sintaksore më vete: të pavarura apo të varura nga njësi-strofa pararendëse, pohojmë që kjo dukuri është një karakteristikë e vjershërimit të Pjetër Budit. Me këtë ndarje, si syth më vete të vështrimit tonë, duam të themi se në vargun e organizimit poetik në 4 vargje (strofa), gjenden përherë “strofa-nyje”, ku zë fill ligjërimi i autorit dhe që dallohen sepse janë strofa, të cilat mund të qëndrojnë gjuhësisht (sintaksorisht) më vete, ndryshe nga strofat në vijim, që lidhen varg njëra pas tjetrës, të prirë ose jo nga konektivët, si në f. 221:

Mesia /qi patnë thanë./
E profetët predikuom/
Se kã me ardhë/ me dhanë
Fënë/ e me na shëlbuom./

I cili /si e mbërrini/
E i gjet gjithë ndë vāj/
Të madh t’idhunë i hini/
Mã lot [t]ë s’mun i mbāj./


Së pari, duhet thënë që struktura sintaksore e strofës II, lidhet me konektivin përemëror “i cili”, që është një rimarrje e subjektit të përmendur në strofën e parë “Mesia”.

E dyta, ky ndërtim gjuhësor i gjithë strofës nuk mund të qëndrojë nga ana kuptimore pa u lidhur me atë që thuhet në strofën e parë.

Së treti, të dy subjektet në vargjet e para të strofave u prijnë njërive drejtuese, të cilat dalin me ndërprerje sintaksore (ndërmjetime të dy njërive);

E katërta, në poezinë budiane, ka jo rrallë, mjete të lidhjes sintaksore, më së shumti, lidhëza të bashkimeve me hipotaksë, që në tërësinë e frazës, dalin të tepërta; kështu në vargun III, lidhëza “se” është e panevojshme, madje, që prish sintaksën e 4 vargjeve;

E pesta, përmiri lidhor “**I cili**” (në strofën e dytë), duhet zëvendësuar me përmirin vetor “Ai”, që struktura të qëndrojë më vete, përndryshe ajo duhet t’i bashkëngjitet strofës së parë. Me zëvendësimin përemëror (**I cili**/Ai) dhe skema e përbërësve predikativë e dy strofave do të na shfaqet simetrike, si më poshtë:



Në rendin e parë vendosen njësitë drejtuese: fjali kryesore (prej të cilave nuk ka varësi sintaksore funksionale; këtu: fjalia III e rendit të parë) dhe fjali drejtuese, prej të cilave vjen e krijohet një hierarki strukturore. Njësitë e rendit të parë shënojnë edhe QOS (qendrat e organizimit sintaksor të frazës).

Në mjetet e lidhjes sintaksore, gjejmë te Budi edhe ato dialektore, të cilat ai i përdor krahas trajtave normative, siç janë sot, f.v., për fjalitë kohore,

ndeshen edhe lidhëza “kur”, edhe “ke”, apo “ndonëse e sikur” krahas “ndë”; nga ana tjetër, në poetikën e P. Budit shfaqen edhe modele të kallëzuesve me ndërtime enumerative ose *endiade*, siç ka vërejtur J. Rrota.⁴⁸

Kūr faqeje...mbë qiellt *u ngre e shkoi*,/ *Ke* vote me i gëzuom,/ Gjithë e panë/*ke* hipi...etj.
Se/ ndë bafshi pëndesë/mkateshit me u larguom...*Ndonëse* kam menguom...etj.

Në veçoritë sintaksore të poetikës së P. Budit do të përfshijmë edhe përdorimin me vlerë stilistike të përsëritjes së ndonjë mjeti të lidhjes së njësive (sintagma apo fjali), në vargjet e para të disa strofave radhazi, si: *Ndo* ke jē tue punuom,.../ *Ndo* ke je tu'kujuom,.../ *Ndo* fort tue gëzuom,.../ *Ndo* ndë valle tu'kënduom,.../ *Ndo* ke jē tu'pushuom,.../ *Ndo* ke jē nism e nçoum,.. / *Ndo* fort mlakunë e rrëzuom,.../ *Ndo* për gjā tue gjuom,... (f. 91-92).

Përfundime

Pas kësaj paraqitjeje të shkurtër të poetikës së Budit, mund të radhitim disa konkluzione, ndër të cilat:

- Shkrimtari i vjetër i letërsisë sonë, P. Budi, është quajtur me të drejtë edhe poeti i parë në historinë e letërsisë shqipe, që na ka lënë një trashëgimi jo të pakët të poezisë shqipe.
- Në vështrimin letrar dhe stilistik vjershërimi i Budit vjen mjaft i arrirë, në pikëpamje të metrit, ritmit, theksave të vargjeve dhe figuracionit. Mbizotëron te ky poet 8-rrokëshi.
- Nga hulumtimi i shkurtër që i bëmë sistemit të rimemave, ka mbizotërim të rimave foljore, çka e zbret në njëfarë mënyre aftësinë krijuese të autorit she stilin e lartë që kërkon vjershërimi.
- Themë me bindje që ligjërimi i shkruar poetik i Pjetër Budit nuk shfaq ndikime nga gjuhët latine e neolatine, siç mund të dallojmë tek ai disa segmente e paragrafë të prozës liturgjike, të përkthyer në tri veprat e njohura, përveç disa leksemave që ai duket sikur i ka përdorur sipas modeleve të shqipes.
- Në poetikën e Budit ka tablo gjuhësore të gjalla dhe plot ndjenjë, ku dalin në pah poetizime të fjalës dhe zgjedhjeve që arrin të bëjë poeti.

⁴⁸ J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 405. [Shkruan autori: *Në dëshir Shqiptari, që t'a shprehë sa ma fort, të qartë e të pikatunë një veprë, posaçe poeti i popullit, kahë s'duket mjaft një verb, shkon e i shton këtij për bri edhe një tjetër, me kuptim thuejse gati sinonim me te. Kjo mënyrë përsëritjesh së verbit quhet ndërtime enumerativ.*]

- Trashëgimi poetik i Pjetër Budit mund të bëhet objekt hulumtimi e kërkimi që nga vjershërimi dhe struktura e tij, ashtu edhe nga leksiku, sintagmat poetike, fjalëformimi dhe sidomos sintaksa e vargjeve.
- Siç mund të vihet re edhe nga prurjet e mësipërme, themi se në poetikën e këtij shkrimtari është e mundur të gjejmë mjaft përbërës që i takojnë poezisë, që nga variacioni i klauzolave, rimema, në figuracionin e thjeshtë, në theksat ritmikë e logjikë, në zgjedhjen e leksikut sipas situatave të gëzueshme dhe tragjike, të qeta e të vrullshme, me sekuenca përshtuese dhe dinamike vepruese të ngadalshme dhe të përshpejtuara, siç janë ato të dënimit të Mesisë etj.
- Trashëgimi letrar poetik i P. Budit bie në sy edhe nëse shkrimtaria e tij në vargje merret e analizohet në rrafshin e sintaksës së saj të veçantë.
- Mund të gjykohet gjithashtu, se me sintaksën e prodhimit letrar në vargje të Budit, është e mundur të shihen edhe tregues të sintaksës historike, si në strukturë, ashtu edhe në mjetet e lidhjes në përbërësve të njëjësive kumtuese.

BIBLIOGRAFI

- Baylon, Christian & Mignot Xavier: *Komunikimi*, Logos-A, Nathan Université, 2003, Përktheu: prof.Xhevat Lloshi). Faik Konica, Prishtinë, 2017.
- Beccaria, Gian Luigi, *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Nuova edizione, Piccola Biblioteca Einaudi, Torino, 2004.
- Berisha, Anton Nikë dhe Berisha, Labinot, *Ligjërime rreth tekstit letrar poetik*, Faik Konica, Prishtinë, 2017.
- Budi, Pjetër, *Poezi*, Prishtinë, 2006. [Parathënia, tejskrimi dhe komentet: Rexhep Ismajli, Botohet me rastin e 440-vjetorit të lindjes së autorit, nga ASH dhe Arteve të Kosovës, Libri 31]
- Çeliku, Mehmet, *Parafjalët e shqipes standarde*, Shtëpia Botuese "Ilar", Tiranë, 2019.
- Domi, Mahir, "Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore", *Studime filologjike*, 1984/4.
- Gero, Mina, *Fjalori rimor i Dritëro Agollit* (Morfologjia e rimemave-Konkordanca – Fjalësi), Toena, 2013.
- Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 1995.
- Gramatika e gjuhës shqipe II*. ASHSH, IGJL, Tiranë, 1996.
- Kelmendi, Tafil, *Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2010.
- Leka, Ferdinand, *Fjalor i termave të letërsisë*, Infobotues, Tiranë, 2013.
- Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 1912.
- Mëniku, Linda, *Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe*, albas, Tiranë, 2014.
- Mjeda, Ndre, *Vepra letrare-1*, Shtëpia botuese "N. Frashëri", Tiranë, 1988.
- Mjeda, Ndre, *Vepra letrare-2*, Shtëpia botuese "N. Frashëri", Tiranë, 1988.

- Përnaska, Remzi, *Gjuhësi...gjuhësore-1*, Maluka, Tiranë, 2015.
- Plangarica, Tomorr, *Në tekst për tekstin – Studime, Shtëpia Botuese “Sejko”*, Elbasan, 2002.
- Rrota, Justin, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
- Sinani, Shaban, *Mjedlogji-3*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Lezhë, 2016.
- Telve, Stefano, *L’italiano: frasi e testo*, Carocci editore, Bussole, S.p.A. Roma, 2013.

SUMMARY

A LINGUISTIC OVERVIEW OF RHYMING IN PETER BUDI'S POEMS

This study of a fragment extracted from a corpus of P. Budi's poetics (Pjetër Budi, *Poezi*, Prishtinë, 2006, by R. Ismajli), as the only original work of this seventeenth-century writer, pursues some partial aims, among which, in addition to verse clauses, attention has been paid to: the linguistic phenomenon of rhymes, respectively to word classes, rhyme schemes, their frequency in the text, syntactic order and function, by syntactically distinguishing sentence units. Furthermore, the article tries to reflect the constructions and figures of speech that Budi managed to create more than four centuries ago, such as repetition, ellipsis and l'enjambement. Rhyming lexical items, those with assonance or simply, as verse clauses, belong numerically to the subject matter covered by this article. The article also covers the presentation of syntactic structures like: the sentence, the phrase, as a unit of expression in spoken and written discourse, as well as the poetic linguistic text, as a phrase-related discourse unit. They are not brought according to the original punctuation, but rather based on the meaning and construction of the above units, taking into account the order of their constituting components. This in-depth overview conducted by the author, constitutes the first entirely linguistic description of the poetics of Peter Budi, one of the oldest Northern Albanian writers. Out of the complete research, the first chapter entitled "Këtu desha me vëm këtë imnë...", has been extracted.